



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave si dhe nenin 5, paragrafi 2 dhe 3, të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele, me datën 20 mars 2024, mori këtë:

**VENDIM**

- I. **OBLIGOHET** operatori i shpërndarjes ARTMOTION që menjëherë t'i largojë nga transmetimi kanalet ARENA SPORT, me qëllim të respektimit dhe parandalimit të cenimit të të drejtave të transmetimit për ligat sportive, të cilat transmetohen përmes kanaleve Arena Sport në territorin e Republikës së Kosovës;
- II. Udhëzohet Zyra Ekzekutive e KPM-së të fillojë një proces të verifikimit administrativ të zinxhirit të të drejtave të transmetimit për të gjitha ligat sportive të transmetuara nga ana e kanaleve Arena përmes operatorëve të shpërndarjes në territorin e Republikës së Kosovës;
- III. Ky vendim mbetet në fuqi deri atëherë kur KPM sigurohet se ARENA SPORT respekton të gjitha rregulloret e KPM-së dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Operatori Artmotion me datën 4 tetor 2021 ka deponuar në KPM një marrëveshje të lidhur me Arena Channels Group, përmes të cilës ka siguruar të drejtat e ritransmetimit të kanaleve Arena Sport në territorin e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Operatori Artmotion me datën 28 shtator 2023 ka deponuar në KPM një "Letër Konfirmim" të lëshuar nga Arena Group në të cilën theksohet se Artmotion ka të drejtat e ritransmetimit të autorizuar nga Arena për territorin e Kosovës për ligat sportive si:

- a. Premier League;
- b. UEFA Champions League;
- c. UEFA Europe;
- d. UEFA Conference League;
- e. Italian League;
- f. NBA;
- g. Spanish League.



KPM, me datën 13 mars 2024 ka pranuar një letër të Premier League të datës 12 mars 2024, përmes të cilës sqarohet se Premier League nuk e ka autorizuar Arenën për t'i lejuar operatorit Artmotion transmetimin e ngjarjeve sportive të Premier League në territorin e Republikës së Kosovës.

KPM ka analizuar letrën e Premier League të datës 12 mars 2024, në ndërlidhje me konfirmimin e Arena Channels të datës 27 shtator 2023, me qëllim të sqarimit të të drejtave të transmetimit të Premier League në territorin e Republikës së Kosovës.

Pas analizimit të fakteve të deponuara në KPM, vërehet se “Letër Konfirmimi” i datës 27 shtator 2023, i dorëzuar nga Artmotion nuk është në linjë me sqarimet e dhëna nga dhënësi i të drejtave Premier League, i cili mohon se ka autorizuar Arenën për t’i kaluar të drejtat e transmetimit të Premier League tek operatori Artmotion, fakt ky i cili vërteton se konfirmimi i Arena Channel në lidhje me sigurimin e të drejtave për Premier League është i pasaktë, ka vënë në lajthitje KPM-në dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Në rastin konkret, pas letrës së datës 12 mars të Premier League KPM-së nuk i është ofruar ndonjë dëshmi/ marrëveshje që e dëshmon të kundërtën, edhe përkundër kërkesës së KPM-së që të ofrohen marrëveshjet e tilla, prandaj letra e fundit e Premier League, hedh në dyshim të gjitha të drejtat sportive që Arena pretendon se i ka, dhe kjo përbën element esencial për t’i tërhequr nga skema programore, meqë ekzistenca e tyre pas kësaj letrë përbën shkelje të Ligjit dhe rregulloreve të KPM-së.

Përmes dokumentit të pasaktë të lëshuar nga kompania ARENA Channels Group dhe deponuar në KPM nga kompania Artmotion, është shfrytëzuar tregu vendor në mënyrë ilegale duke rezultuar në deformime në treg dhe konkurrencë jo-lojale. Gjithashtu, ARENA ka dështuar të respektojë zotimet e saja se do t’i respektojë rregulloret e KPM-së, zotim i cili ishte marrë parasysh kur KPM kishte marrë vendim që t’i kthente në transmetim kanalet sportive ARENA, si rezultat i shkeljeve të mëhershme kur ishte rrezikuar siguria kombëtare nga po këto kanale. Për më shumë, pas monitorimeve të bëra nga Departamenti i Frekuencave është vërtetuar se kanalet sportive ARENA janë duke ndërhyrë në territorin e Republikës së Kosovës përmes transmetimeve dixhitale tokësore nga territori i Serbisë. Këto transmetime nuk janë autorizuar nga Republika e Kosovës, çrregullojnë tregun medial, shkelin Marrëveshjen e Telekomunikacionit të arritur në Bruksel në vitin 2013 mes Kosovës e Serbisë, dhe si të tilla edhe mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare.

Sqarimet e dhëna nga dhënësi i të drejtave për ngjarjet sportive të ligës së Anglisë “Premier League” vënë në dyshim ekzistimin e të drejtave që Arena Channel pretendon të ketë edhe për ligat tjera sportive të lartpërmendura dhe se KPM si masë proporcionale, me qëllim të respektimit dhe parandalimit të cenimit të të drejtave të transmetimit për ligat sportive të cilat transmetohen përmes kanaleve Arena Sport, si dhe respektimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve të KPM-së, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

**Këshillë juridike:** Pala mund të parashtrojë ankesë në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, në Bordin për Ankesa. Ankesa nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.



Jeton MEHMETI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.03.2024  
Data